

E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Fokusi i muajit

PROGRAMI I TRANSPARENCËS

Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" detyron autoritetet publike për të përgatitur, publikuar, dhe përditësuar programin e transparencës për akses në informacione, duke përcaktuar saktë kategoritë e informacionit që duhet të përmbajë programi. Publikimi proaktiv i informacionit në faqet e internetit nga ana e autoriteteve publike krijon mundësinë e aksesit në të njëjtën kohë të një numri të madh individësh, rrit transparencën institucionale, ul numrin e kërkesave për informim si dhe rrit llogaridhënien e autoriteteve publike.

Në programin e transparencës, i cili duhet të miratohet nga titullari i institucionit dhe duhet të jetë publik jo vetëm në faqen e internetit por edhe në ambientet e institucionit, duhet të publikohen informacione në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme.

Autoriteti publik kërkohet të krijojë dhe arkivojë një kopje dixhitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë. Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga autoritetet publike.

Në nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" janë të specifikuar kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publik. Në publikimin e informacionit, AP duhet të mbajnë parasysh interesin e publikut si dhe të mundësojnë aksesimin lehtësisht në informacionin publik.

Përmbledhje mujore e vendimeve

Vendim nr. 36

Kopja e dokumentit zyrtarë është informacion publik

Vendim nr. 37

Informacioni për personat publik ose punonjës të administratës publike nëpërmjet të cilëve pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre përbën informacion publik.

Vendimarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), gjatë muajit qershor, ka dhënë 2 vendime në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI). Të gjitha vendimet kanë qenë vendime urdhërimi ndaj autoriteteve publike për të dhënë informacionin e kërkuar.

Me anë të Vendimit nr. 37 datë 07.08.2020 Zyra e Komisionerit ka pranuar ankesën e gazetarit A.R i cili i kërkonte Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoriteti Publik) ndër të tjera informacion mbi "Listën emërore të Komisionit të konkursit që shpalli fituesin e ankandit për Parkun (140 MW) të paneleve fotovoltaike në Karavasta; pozicionin (ekspertizën) e secilit anëtar të Komisionit, si dhe formimin e tyre profesional (psh.: nëse ka qenë inxhinier, çfarë lloj inxhinieri, jurist apo ekonomist).

Autoriteti Publik në përgjigjen e tij përfundimtare arsyetonte se "Komisioni i Posaçëm (...) për përzgjedhjen e projektit që do të përfitojë nga masat mbështetëse për ndërtimin e Implantit Fotovoltaik në zonën e Karavastës" përveç detyrave për hartimin e dokumentacionit të procedurës konkurruese dhe ndjekjes së procedurës, aktualisht po trajtonte edhe negociimin e kontratës finale me shoqërinë fituese.

Duke qenë se kjo procedurë ishte akoma në ndjekje dhe palët ishin ende duke negociuar për të finalizuar kontratën finale, Autoriteti Publik e konsideronte informacionin e kërkuar si rast përjashtues/kufizues të ligjit për të drejtën e informimit.



TRANSPARENCA E AUTORITETEVE PUBLIKE ËSHTË PARADHOMA E MIRËQEVERISJES

VIZITONI WWW.IDP.AL

#informim #transparencë #vendim

KDIMDP pasi shqyrtoi ankesën e gazetarit si dhe duke mbajtur në konsideratë përgjigjen e autoritetit publik, në përfundim të procedurës së shqyrtimit administrativ të çështjes, vlerësoi se pretendimet e paraqitura nga autoriteti publik janë të pabazuara në ligj.

KDIMDP vlerëson se, duke qenë se informacioni i kërkuar lidhet me funksionarë publikë, ky informacion duhet vënë në dispozicion, pasi gjen zbatim shkronja b) e pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.200 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, në të cilin parashikohet se: "Ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave vetëm për rastet kur jepet informacion për persona publik zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre". Parashikim ky, i cili zbatohet në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave të parashikuar në nenin 5 të ligjit të sipërcituar.

Në përfundim KDIMDP vlerësoi se ndryshe nga sa pretendimi i autoritetit publik, është i pabazuar në ligj dhe për këtë arsye vendosi Urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit të kërkuar.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimin në faqen e KDIMDP www.idp.al

TË NJOHIM KOORDINATORËT E TË DREJTËS PËR INFORMIM

ZYRA E KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHË MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Emër Mbiemër: Alketa Koja

Funksioni: Inspektor

Drejtoria: Drejtoria e të Drejtës për Informim

Autoriteti Publik: Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Data e emërimit si koordinator: dhjetor 2014

Eksperienca të mëparshme si koordinator për të drejtën e informimit: Jo

Email: info@idp.al

Nr. telefonit: 042237200

Numri i kërkesave për informacion të regjistruar gjatë vitit 2020: 24 kërkesa për informacion

Si e vlerësoni nivelin e transparencës së autoritetit publik ku ju punoni?

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është një nga institucionet më transparente. Zyra publikon dhe përditëson sa herë ka ndryshime të gjitha informacionet e parashikuara nga Programi i Transparencës. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit publikon menjëherë pas miratimit çdo akt administrativ si vendime, rekomandime, opinione dhe mendime mbi aktet e dërguara për konsultim.

Cila është vështirësia më e madhe që hasni në detyrën tuaj si koordinator për të drejtën e informimit? Zyra e Komisionerit është totalisht e dedikuar për të kthyer përgjigje kërkesave për informacion në kohën me të shkurtër të mundshme dhe në këtë aspekt kam mirëkuptimin dhe dedikimin e të gjithë institucionit. Rasti i vetëm kur jam ndjerë disi në vështirësi ka qenë vitin e kaluar kur institucionit i kërkoheshin kopje të të gjitha ankesave për vitin 2019. Në vetëm 10 ditë arritëm të nxirrnim nga arkivi mbi 700 dosje, ti fotokopjonim, anonimizonim dhe rikopjonim sërish.

Cili është sugjerimi juaj për përmirësim në zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit?

Sugjerimi im ka të bëjë me statusin e koordinatorit për të drejtën për informim. Do të ishte mirë që koordinatori për të drejtën e informimit të gëzonte një status të veçantë brenda institucionit në të cilin ai punon dhe të kishte një mbrojtje më të madhe, mundësisht të siguar nga një institucion i pavarur, në mënyrë analoge siç është oficeri i mbrojtjes së të dhënave personale në legjislacionin evropian.

28 SHTATOR

28 SHTATOR

28 SHTATOR

**DITA NDËRKOMBËTARE E TË DREJTËS PËR
INFORMIM**